



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË PARË TË RREGULLT TË KUVENDIT KOMUNAL TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Mbledhja është mbajtur më 30.01.2017 (E Hënë) në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h.

Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit z.Naim Pira, kryetari i komunës z.Sokol Haliti, nënkryetari i Komunës z.Hasan Aliu; këshilltarët e Kuvendit: Sami Demelezi, Zekrija Zuka, Nexhat Aliu, Xhilsime Qamili, Ali Bajrami, Adnan Imeri, Vjollca Kadolli - Halili, Nuredin Lutfiu, Ajtene Frangu, Bekim Azizi, Samet Idrizi, Taib Alidema, Hyse Rama, Visar Demiri, Bislim Bislimaj, Sejdi Emini, Baki Nebiu Daut Xhemajli, Vjollca Sylejmani, Ekrem Abazi, Mirlinda Sadiku, Vehbi Rama, Majlinda Ostrogllava, Selvije Rexhepi, Besjana Rexhepi, ndërsa në mbledhje mungoj Arbëresha Ibrahim. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësuesja e Zyrës Ligjore, përfaqësuesi i Zyrës për Integritet Evropian, mjetet e shkruara.

Pasi u konstatua se prezent janë 26 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi z.Naim Pira: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e parë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Më lejoni të përshëndes Kryetarin z.Sokol Halitin, nënkryetarin e Komunës, z.Hasan Aliu, juve të respektuar Këshilltar komunal, Drejtorë të drejtorive të cilët janë prezent në këtë seancë, përfaqësuesit e OSBE-së, mediat e shkruara. Pasi që është seanca e parë e vitin 2017 ju dëshiroj shumë shëndet e punë të mbarë. Më lejoni të ju informoj, se Zyra Ligjore e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, na ka konfirmu ligjshmërinë e akteve. Para se të kalojmë te miratimi i rendit të ditës, nëse ka dikush të parashtrij pyetje ose propozime, fjala është për ju, urdhëroni.

znj.Mirlinda Sadiku: Përshëndetje Kryetar, Kryesues e ju te pranishëm! Kam pyetje për udhëheqësinë komunale. Vitia nuk ka të dhëna për infrastrukturën nëntokësore, përbënë rrezik për dëmtimin e rrjetit gjate implementimit të rrjeteve të ndryshme, qoftë kanalizim qoftë ujësjellës: A keni parapa naj herë me bë naj infrastrukturë që dijet se ka naj intervenim najkune,

me dit sekt se ku është demi? Po ashtu kame pyetje për drejtorin e Arsimit, shkolla e Lybishtes që një muaj nuk ka ujë: Cila është arsyeja? Për drejtorin e Bujqësisë kam pyetje, në vitin e kaluar kishim një epidemi, te sëmundja gungore e lëkurës, më intereson ta di: Komuna e Vitisë sa është e prekur nga kjo, sa është numëri i fermave që janë prekur, sa është numri i lopëve, sa është demi i cili është vlerësu nga Komuna e Vitisë, a do te jepet kompensim demi këtyre fermerëve, qoftë nga buxheti komunal, qoftë nga niveli qendror?

Znj.Besijana Rexhepi: Përshëndetje të nderuar! Unë kam një kërkesë në emër të qytetarëve dhe të Kryesisë së fshatit Ballancë, po ju drejtohem institucioneve komunale me qellim shqetësimin të kamotshëm te këtyre banorëve, fjala është për zgjerimin dhe vendosje e rrethojave në urën e këtij fshati, përkatësish ne vend daljen e lagjes “Musliu” dhe “Januzi”, pjesë kjo e cila rrezikon shume qarkullimin e automjeteve në të dy drejtimet për shkak të ngushtësisë se saj, por, edhe jetrat e njerëzve. Së fundi edhe me 9 Janar 2017 ne këtë lokalitet ka ndodhur një aksident, të cilin mund ta shihni edhe ne këtë foto, ku e vërejmë rrëshqitjen e këtij automjeti, njëherë siç e dimi, ky fshat posedon rrugët e ngushta dhe konform kësaj banoret kërkojnë që te pastrohen rrugët prej borës, për të evituar aksidentet e tjera të mundshme, shpresoj që ti kushtoni vëmendje këtyre kërkesave.

z.Bislim Bislimi: Përshëndetje, unë dua ta ngris një çështje që kohëve të fundit po na shqetëson dhe është bë problem i madh për qytetarët e Vitisë, është fjala për “Eko Higjienën”. Qytetaret janë të shqetësuar me problemet e mbeturinave në të gjithë komunën tonë, kjo kompani u themeluar si organizatë publiko private, me përqindje 49% me 51%, në llogari të kompanisë së huaj. Investitori ka qenë i obliguar që të investoj një sasi të mjeteve dikun 1 milion e 500 mije euro, kjo jo që nuk ndodhi, por, kompania shet edhe asetet e njësisë së ish-ndërmarrjes “Universali” dhe me një vlerë te caktuar e nga 22 punëtorë të kësaj kompanie, të cilët janë momentalisht duke punuar, po i kërkojnë paratë e trustit, te cilët gjate vitit 2008-2011 nuk ju janë dhënë. Ata kane bë padi edhe ne gjyqe, pra, me një fjali kompania jo vetëm që nuk ju përmbajt obligimeve, po po i diskriminon punëtorët dhe po e shkatërron njësinë e ndërmarrjes, nga 22 punëtorë të cilët nuk e kanë nënshkruar kontratën e punës, tre janë largu ma te zëshmit, ata që kane qenë më këmbëngulës, ndërsa te tjerët nuk e kanë të siguar pagën mujore tash për këtë muaj. Ma merr mendja që ky problem pa u zgjidh brenda komunës sonë dhe pa e bë një takim, një mbledhje ose në Kuvend një mbledhje të jashtëzakonshme, nuk mujm ta zgjidhmi. Tash mbeturinat nuk shifen se ku janë, kur te shtrihet bora do t’i shofim gjithë andej mbeturinat. Punëtorët po punojnë vullnetarisht pa paga, e ku rrezikojnë edhe shëndetin e tyre, ma merr mendja që duhet mu bë një zgjidhje, e ku kryetari duhet ta shfrytëzoj hapësirën ligjore e mu be kompani në veti.

z.Vehbi Rama: Përshëndetje për te gjithë! Unë kisha një shqetësim, se ne shtëpinë e shëndetit në Viti mungojnë gjerat elementare, barnat, inksionet me te thjeshta, kjo me ka ndodhur mua, me 10 janar kisha një anëtar të familjes për mjekim, ku merre me mend mungojnë inksionet elementare për dhimbje të quajtur ranitoll, ku stafi mjekësor i kujdestarisë e falënderoj dhe me

te vetmen mundësi që patën ma dhanë udhëzimin për Gjilan. Merrne me mend kur shkova ne Gjilan ai ranitall kushtojmë hiq me shume se 40 cent, e mu desht mua ne Viti-Gjilan të bej rrugë ku ka pas edhe pacienta të tjerë, e ku mu mu desh për një barn 40 cent me i bë 40 klm. Kjo nuk është për fajin e mjekut, por, është për fajin e furnizimit të drejtorisë e të ministrisë. Kërkesa tjetër është, kam nga prindit nxënësve të shkollës “Dëshmorët e Vitisë”, ata mu kanë anku se dëshirojnë të behet ndryshimi i orarit nga ora 08 në ora 10, për arsyeje se janë kushtet atmosferike të ftohta, të ndryshohet orari kam edhe nënshkrime e prindërve. Para se me ardh këtu kam qenë te drejtori i shkollës, kam bisedu, ai me tha që nesra do ta thërras një takim me mësimdhënës, ku do t’i ftoj prindit dhe të bëj ndryshimet e orarit. Kjo ka ndodh me 19 janar e ku nuk janë ftuar prindërit, e kjo duhet ta dinë mësimdhënësit se ndoshta nuk ju konvenon, por duhet te jetë në të mirë të nxënësve, për arsye se fundi i fundit mësimdhënësit janë mësuesit e tyre, janë edukatorët e tyre, por, nuk janë shefat e tyre. Prandaj, duhet te ndryshohet orari për hir e për te mirën e nxënësve.

z.Samet Idrixi: I nderuari Kryesues, Kryetar, Nënkyetar, te gjithë te pranishmit, përshëndetje! Javën e kalume e pamë që ne fshatin Debullde ka probleme serioze me furnizim me ujë të pijshëm. Unë e di që tash nuk mujmë të bëjmë kurgja në këtë kohë me borë, por, kërkoj prej qeverisë komunale, ta ketë parasysh, që vitin e ardhshëm gjithsesi aty të investoj dhe ta rregullojnë ujësjellësin, edhe ashtu nuk është një kosto e madhe, se nuk mundet me pas shumë shpija që me pas profil të madhe te gypave e te rezervave. E kam një pyetje, i kame pa disa punëtor me kontratë në vepër, që kanë punuar rrugëve, kane fshi, kanë pastru, është shumë mirë, nuk e di nëse kanë ende afat të kontratës, dhe sa kam vërejt unë, nuk janë angazhuar sa duhet ne pastrimin e borës. Bora rrugëve qendrore është pastru deri dikun, por, rrugët periferike shumë më pak. Nëse vërtet ka qenë një numër kaq i madh i punëtorëve me kontratë ne vepër në pastrim, ata kanë mujt mu angazhu me i pastru trotuaret, se paku me lopata, se trotuaret kanë qenë të bllokuar edhe nëpër qendër edhe ne rrugët dytësore. Kam pa nxënëse që vazhdimisht janë ekspozu rrezikut gjate shkuarjes në shkollë, prej veturave.

z.Bekim Azizi: Përshëndetje për te gjithë te pranishmit! Unë në fillim isha lidhur të mirëmbajta dimërore, një dështim total, rrugët të cilat kanë qenë në menaxhim për tu mirëmbajta, te cilat ende janë me akull, e ku po dalin banoret me kazme duke e hekur, e qato që i keni pastru ju nuk janë pastru mirë, po shihet që trotuaret janë të bllokuar, një dështim total, pagesat janë ba, ndërsa puna nuk po kryhet. E kemi parasysh që dimri ka qenë kohë e ftoftë, temperaturat e ulëta, e dimë që një pjesë e shkollave nuk kanë filluar me kohë. Në disa shkolla nuk kanë funksionu nxemjet, ka shkollë që mësimdhënësit kanë mbledh pare me i rregullu nxemjet, shkolla në Sodovinë të Qerkezve, me 28 Nëntor e keni bë prokurimin, d.m.th vetëm tri javë është punu, ka pelsitë nxemja, ndërsa gjysmëvjetori i dytë prapë ka filluar në shkollën e vjetër, d.m.th edhe ajo nxemje që është rregullu para një muaji edhe ajo është ngri edhe asaj nuk i keni qit antifriz edhe aty është bë një keqpërdorim. Unë isha lidh te konkurset në shkolla, tashti të janarit një konkurs për histori, ndahet një normë, ne as një formë ligjore nuk keni te drejt mu nda norma ne dy pjesë,

ndahet norma ka 10 ore për me ju da një normë ose me ju bë një vend i punës vajzës se punëtorit që punon në Drejtorinë e Arsimit, edhe atë nuk pranohet mësimdhënësi me Histori, që është me 4 vjet, që ka kualifikimin 4 vjeçar, prapë injorohet kandidati që i plotëson kushtet edhe pse nuk qiten poentimi i kandidatëve, qeto piket mu publiku. Njëjtë është vepru me Gjografi në shkollën e Gjymnazit në Pozharan, është pranuar me bachelor, që është i lëmishëm se edukimit, që nuk është për shkollë të mesme, është refuzuar me drejtim të gjeografisë me FSHMN, është bërë prapë shkëlqej këtu. Pse nuk rishpallet konkursi për drejtimin e kimit në gjimnaz, e keni rekomandimin e inspektorëve të arsimit? Atje e keni pranuar me kimi ingjinerike, e keni refuzuar me kimi arsimorë, i keni rekomandimet e inspektorëve, të avokatit të popullit që po i qet krejt keq, na jemi tu i pa që jeni tu bërë shkëlqej.

z.Baki Nebiu: Përshëndetje për të gjithë! I kame disa pyetje, një pyetje e kame për drejtorin e Inspeksionit. Në vitin e kaluar i keni pas disa intervenime në fshatin Kabash, duke e liruar pronën publike të uzurpuar, dëshiroj të di a do të ketë kësi intervenime edhe këtë vit, pasi që jeni njoftu edhe ti, se si Kabashi edhe shumë fshatra të tjerë janë pronat publike të uzurpuara nga qytetarët: A do të ketë intervenime edhe këtë vit? Pyetje tjetër për kryetarin, në emisionin Jeta në Kosovë, e pata bërë një pyetje për kapakët e kanalizimit, ti mu ki përgjigj, se do t'i ndërroj ata, kurse hala sot e kësaj dite ata kapak nuk janë ndërru: A do ti ndërroni këtë vit?, se pasojat e këtyre kapakëve do ti shohim pasi të shkrihet kjo borë. Pyetja tjetër, në miratimin e buxhetit kemi miratu një shumë të konsiderueshme për rregullimin e trotuareve dhe ndriçimin publik. Rruga "Hajdin Demiri" për Pozharan, mendoj që duhet ta ketë një pikëpamje të mirë, pasi që konsideroj që ka një rrezikshmëri të madhe për këmbësoret që qarkullojnë në atë rrugë, por, edhe për nxënësit. Pyetja tjetër për drejtorin e Arsimit, kam informacione që në disa shkolla fillore nuk funksionojnë nxemjet qendrore si pasojë e ftoftit. Nëse nuk funksionojnë nxemjet si mbahet procesi mësimorë?

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi që nuk ka pyetje tjera, fjalën ja kaloj kryetarit që të ju përgjigjet këtyre pyetjeve.

Kryetari z.Sokola Haliti: Përshëndetje të nderuar Këshilltar komunal e ju të pranishëm, ju dëshiroj një vit të mbarë! Shumica e pyetjeve që u parashtruan janë në interes të qytetarëve, janë konstruktive dhe kanë përgjigje, mirëpo pasi që janë drejtorët këtu, unë pyetjet që u parashtruan për drejtorin përgjigjen drejtorat, mirëpo për lirimin e pronave do të jemi aktiv edhe sivjet shumë, ne vetëm i kemi itiketuar në Viti dy vende e do të jemi aktiv. Te mirëmbajtja dimërore, me të vërtetë është një dimër i ran, ka qenë një situatë e jashtëzakonshme, ku shumica e komunave i kanë shpall gjendje të jashtëzakonshme, ne e kemi shpall gjendjen e ngritjes së gatishmërisë në Viti, unë po thamë se nëse krahasimi me komunat përreth, përjashtim aty ku ka pas ramje të bore si në Ferizaj, Kaçanik, kemi qenë shumë më mirë në kuptimin operacional, rrugët tona kanë qenë më të hapura, kemi pas problematik sidomos në vendet fshatra malor, si në Debellde, rrugën kryesore në disa herë e kemi hapë përmi shkollë, por, rrugët lagjore i kemi pas me vështirë, si të lagjja e "Shaqirve" dhe me thellë, kemi pas në Kulisht problematikë, Buzovikin edhe nëpër fshatra disa, e ku i falënderoj qytetarët që na kanë ndihmu me vet

iniciativa, nga se që 40 fshatra me një gjendje të jashtëzakonshme qyshe ka qenë përveç ramjes se bores edhe temperaturat shumë të ulëta, pëlcitje të gypave ka pas edhe nëpër shpija private ne Prishtinë, Prizren etj, e ku e kemi pas një paus të shkollave, ku nuk ka pas mësim dhe nuk u kanë lehtë, në këtë kuptim unë mendoj që mirë ja kemi arri me i mirëmbajt rrugët, d.m.th nuk ka shku huq gjithçka, kanë qenë të kalueshme, kemi mujt edhe me mirë mujm edhe me mirë, por, unë mendoj që mirë i kemi mbajt. Përgjigjja ime është, se ka mujt me pelësit gypat aty këtu i kemi pas tri shkolla, që i kompensojmë me mësim, ka ndodhe edhe me përpara që nëpër shkolla me pelësit gypi siç ndodh edhe nëpër shpija, mirëpo përgjegjësia është në nivel, na jemi tu marr me këto çështje, jem tu mubilizu me kalu këtë situatë. Ta kemi parasysh, temperaturat kanë qenë afër -30, për kapacitetet tona ka qenë e ranë. Te konkurset, është drejtori këtu, gjithçka që shkon jo ligjore janë komisionet, kanë përgjegjësi. Drejtorja e Arsimit nuk është partiake, bile bile nëse është atëherë është partiake e Qeverisë se kalume në kuptimin shumicë e kame fjalën, por unë konsideroj që është institucionale, janë anëtarët e komisioneve aty, janë njerëz që ju i keni sistemu të gjithë aty dhe një nuk është largu ose diferencu, janë aty prezent. Unë po te tham një, krahasuar me vitet e kaluara gjendja është shumë më e mirë, ti nuk po përmend edhe senet te mira, p.sh.: ai kryetari i forumit te PDK-së u zgjedhe mësimdhënës, se pat kriter dhe u respektu kriteri ligjor. Furnizim me ujë të pijshëm ne fshatin Dedellde, njëjtë e kam kërkesën për ty Samet, që me na ndihmu për ujë të pijshëm, pasi që punon ne kompani “Hidromorava”, është kompani regjionale, e po të tham se Debelldehu është në planifikim sivjet me buxhet komunal e kemi planifiku një rivitalizim të ujit në Debellde, ujin e vjetër, por, do ta rivitalizojmë me kapacitete të komunës. Për te “Eko Higjiëna” që ke një pyetje, ne me kapacitetet e tona kemi ndihmuar, që Vitinë mos ta lëmë në at gjendje të papastërti dhe i kemi lut donatoret, na kane ndihmu dhe kemi bërë hapa, por nuk është e mjaftueshme. Te “Eko Higjiëna” Komuna e Vitisë para këtij mandati ka qenë aut, kur është bërë kontrata me partneri austriak 51 me 49, faktikisht këtu Vitia nuk ka qenë fare aksionare dhe ne për një vit e me shumë i kemi hup duke i kërkuar aksionet e tona si komunë dhe tash ne statut aksionet e tona i kemi, por, ne praktik nuk funksion “Eko Higjiëna” me Gjilanin dhe kanë probleme, e tash komunat e vogla janë te hendikepueme. Në këtë kuptim ne po punojmë që ta bëjmë kompani tonë ligjërish, një takim do te jetë javën e ardhshme, një ekipë do te jetë i përbashkët edhe ne këshilltarët e Kuvendit Komunal do të punojmë me të vërtet, pasi që me ligje nëse ka vullnet qendror politik institucional na kemi të drejt me kriju. Te “Hidro Morava” e kemi aspektin pak tjetër, unë besoj që këtu me donatoret zviceran do te funksionojmë shumë me mirë, sivjet ashtu jemi marr vesh në takimin e parë që e kemi pas me drejtorin ekzekutiv, ndërsa me “Eko Higjiënën” nuk po shoh zgjidhje, për shkak se kanë hi me një rrugë që nuk po shof naj far zgjidhje, e vetmja zgjidhje është kompania rajonale, por, do të njoftohet Kuvendi dhe ajo që kërkohet prej Kuvendit do të jemi bashkë krejt, ne do të përgatitemi, jemi tu punu shumë në këtë drejtim, që ta themelojmë, nuk është letë. Për sa i përket aseteve te tjera, investimeve, investimet kanë ra në ujë, se nuk janë te interesuar në këtë aspekte me investu momentalisht, komuna ka me i kërku asetet e veta, ku në këtë kuptim ne jemi tu be analiza, jemi në kontakt me

punëtorë dhe ne mendojmë që me Pranverë do ta zgjidhim këtë problem në të mirë të qytetarëve. Pyetje për shtëpinë e shëndetit, edhe unë isha në spital në emergjencë në Gjilan javën e kaluar, edhe unë e pash që kishte mungesë të barnave, por, një shërbim ekziston, barnat esenciale janë edhe në Viti, ekzistojnë edhe shërbimet, janë për falënderim i gjithë shërbimi mjekësor. Edhe të ndërimi i orarit në shkollë, ka rëndësi, është një rëndësi edhe aty, mirëpo është drejtorja, këta mundën nëse e shohin të arsyeshme për hir të nxënësve. Të zgjerimi i urës, i rrethojës së urës, në Ballancë kemi pas investime të mjaftueshme, jemi tu bë investime edhe kemi me bë sivjet prapë, është edhe zgjerimi i urës e i rrethojës, kadaladal ato problemet janë zgjidh kryesore në Ballancë. Të sëmundja gungore, kam marr pjesë me një takim, bile me insistimi tim është mbajt takimi i Asociacionit të Komunave me Agjencionin e Veterinës dhe ka qenë Oda Veterinere e Kosovës. E di që Viti ka qenë, ka pri në këtë drejtim me efikasitetin e saj, ndërsa kompensimet kanë mu bë, d.m.th fermerët e dinë, i kanë dërgu shënimet e të dhënave në Agjencinë Veterinere, ku kjo agjenci është kompetencë për kompensimin e këtyre dëmeve.

Drejtori z.Qahil Sinani: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Pyetjet që u parashtruan kanë me vend, ngase që ka qenë një dimër, një acar i madh, por, shkolla e Lybishtes ka ujë, asnjë ditë nuk ka qenë pa ujë, e kamë thirr drejtorin në takim, ujë ka. Për ndryshimin e orarit të shkollës, ka mundësi, ngase që shkolla është një ndërim, por, nuk ka qenë kërkesë e prindërve edhe e shkollës. Për konkurset, lexone mirë udhëzimin administrativ 06/2015, ju po flitni më shumë anash çka po ndëgjoni, se me udhëzim, udhëzimi administrativ tash i ka shu FSHMN-në e fakultet e i ka bë të njëjtë, është me kredi 240 kredi, fakulteti 4 vjeçar, master apo 5 vjeçar 300 kredi. Neni 11.1 dhe neni 11.2 lexone e gjeni, është në këtë çështje. Në 1) vjen masteri ose me 300 kredi; 2) 240 ose fakulteti katër vjeçar dhe 3) vjen fakulteti tre vjeçar ose 180. Ky fakultet 3 vjeçar ose 180 kredi sun merr kontratë të përhershme, është me kontratë vetëm njëvjeçare, prej klasës së 6 deri në klasën e 9 dhe prej klasës së 10 deri në vitin e 12 është nën 1 vjet masteri ose me 300 kredi, 2) 240 ose fakulteti katër vjeçar dhe 3) vjen fakulteti tre vjeçar ose 180, nëse ju thuani mos e zbatu udhëzimin është diçka tjetër, por, këtu është zbatu udhëzimi administrativ. Të nxemjet, 25 objekte janë me nxemje qendrore, në 37 objekte arsimore zhvillohet procesi mësimorë, 12 objekte janë pa nxemje qendrore, me koftorë, prandaj, këto 25 objekte ka qenë e pamundshme të gjitha të kenë, ti qëndroj apo ti përballojnë këtë ftofti të madh. E kemi rastin në Sodovinë, vetëm me një ekspertizë që është bë tash, mbi 1300 euro dëme nga ftofti i madh, ndërsa kemi investu në Gjimnaz 1370 euro. Tash gjatë këtyre ditëve të pushimit, ngase prej ftoftit edhe rrjeti i nxemjes është i vjetruar dhe nuk ka mujt me i përballu ftoftit.

Drejtori z.Skender Ahmeti: Përshëndetje për Kryetarin dhe ju të pranishëm të tjerë! Unë du të ju përgjigjem asamblistëve për pyetjet e parashtruara. Komuna e Vitisë kemi qenë ndër vendet e para për menaxhimin e kësaj sëmundje, kemi qenë së bashku me Komunën e Artanës që jemi kanë më të mirat, dy vendet e para i kemi pas për menaxhimin e kësaj sëmundje. Në Komunën e Vitisë ka pasur 36 ngordhje nga kjo sëmundje dhe dikun rreth 170 krerë të prekura me këtë sëmundje, e kemi menaxhuar shumë mirë, e kemi bë varrosjen në vendet e caktuara, nuk kemi

lënë hapësirë tri katër ditë si komunat tjera, që ju kanë mbet kafshët mbi sipërfaqen tokësore. Për të gjitha dosjet për këto krerë të cilët kanë ngordhur i kemi dorëzuar në Agjensionin dhe së shpejti pritet kompensimi material i tyre. Ndërsa sa i përket pyetjes së Bakiut, lirimi i hapësirave publike, ne kemi marr një aksion me dhunë në Kabash, por, kemi pas edhe shumë lirime të hapësirave publike të cilat nënë kërcënimin e ekzekutimi të dhunshëm vetë qytetarët e kanë liruuar, si p.sh.: të Xhamia në Pozharan, në qytetin e Vitisë, por që fatmirësisht të gjithë qytetarët e kanë mirëpritur dhe ne e kemi bërë planin me kryetarin e komunës, që të vazhdojmë edhe në këtë vit, ku do të vazhdojmë në Viti, Kabash, Smirë.

Drejtoresha znj. Fatbardha Emini: Te nderuar të pranishëm, faleminderit për pyetjet e parashtruara! Lidhur me infrastrukturën rrugore, konkretisht Kadastrën nëntokësore apo siç njihet katastrofi i përqojave, siç e dini Komuna e Vitisë së fundit është duke e zhvilluar bashkëpunimin me USAID-in edhe jemi në planifikim, që për zonën urbane dikun 90 km² që këtë vit të fillojmë edhe me kadastrën nëntokësore, pasi që Komuna e Vitisë deri me tani sa i përket burimeve njerëzore nuk ka mundësi ta kryen vetë këtë projekt, por duhet edhe një kosto që kushton, kështu që kemi gjetë bashkëpunim me partnerin që gjate këtij viti të punojmë edhe me infrastrukturën nëntokësore apo kadastrën nëntokësore.

Drejtori z.Basri Aliu: Përshëndetje për të pranishmit! Unë e kuptoj shqetësimin e asamblistit, por, sa i përket furnizimit me barna nga lista esenciale, e cila është kompetencë e Ministrisë së Shëndetësisë, në krahasim me vitet paraprake ka qenë shumë më mirë dukshëm, por, fluksi i madh i cili ka qenë nga gjendja gripore, që ka mbretur në gjithë Republikën e Kosovës, kanë mund të jetë edhe mungesë e ndonjë bari ose indiksoni që e përmendi asamblisti, ndërsa sa i përket transferit që e kanë dërgu në Gjilan, besoj që mjeku për një ranitall nuk e dërgon pacientin në Gjilan, sepse ana profesionale nuk ja lejon, prandaj duhet të kemi kujdes kur të themi diçka, se stafi shëndetësor ka qenë në gatishmëri këto ditë dhe ka qenë mjaft korrekt edhe me pacient, por, edhe me gjendjen e cila ka mbretëru.

Kryesuesi z.Naim Pira: Drejtorja e Shëndetësisë, së bashku me kryetarin gjate këtij viti ka arrit të marrin donacion dy kerre nga qeveria Japoneze, vlera e të cilëve ka qenë dikun 60-70 mijë euro e se bashku me pajisje tjera.

z.Vehbi Rama: Drejtor, ju me njëfni mue, unë me rrejt nuk rrej, shkoj të shpija ta bi udhëzimin që ma ka dhënë mjeku, e kame të shpija, ku në Viti-Gjilan për një ranitoll, i cili kushton 40 cent, i kam bërë 40 kilometra rrugë, jo vetëm unë po ka pas 5-6 pacienta qat kohë, një prej tyre ka qenë prej fshatit Gjylekar, nëse nuk besoni shkoj ta bi udhëzimin që e kam për në Gjilan, ku është edhe emri i mjekut, me 10 Janar ranitalli ka munguar.

z.Bekim Azizi: Unë po i tham drejtorit të Arsimit, ai le ta këqyr ligjin, mu mos të më kallëzon, unë po tham Histori ki pranë 2 me tre vjeçar, me 3 vjeçar, i ki refuzi me 4 vjeçar, i ke nda norman dy vete ka 10 ore, e ki refuzi 4 vjeçar. 30 vet i ki që punojnë me gjuhë angleze, që japin me përkthyes, që janë. Unë e di që është ftoftë temperatura e ultë, por, shkolla në Sadovinë të Qerkezve, të cilës ja ki pre shiritin me 28 Nëntor, prej 1 dhjetor ka punu tri javë u majte mësimi

aty, kur e ki fillu gjysmëvjetorin e dytë nuk ka punu, d.m.th kanë kalu në shkollë të vjetër, qaty nuk ki qit antifriz, edhe qaty kemi kursy, vetëm antifriz me i pas qit ajo kishe pshtu.

Kryetari z.Sokol Haliti: Paska kup antifrizi, ku kem pas -30 me një shkollë të re që është ndreq e re, kjo qeveri e ka ndreq këtë shkollë edhe e ka ndreq me pare te taksapaguesve, por, ti i ke lanë shkollën në gjysmë ne Ballancë, në Sllatinë e shkollën tane ku ki dhënë mësim. Unë po të them që unë flas me argumente, unë e di që progres ka edhe drejtori, e tha që ka hapa progresiv, se megjithatë në krahasim me vitet e kaluara është shumë më mirë, por, a ka defekte hala, por, duhet me i kuptu se i kemi këto rrethana.

znj.Vjillca Kadolli-Halili: Përshëndetje për Kryetarin, Nënkryetarin e ju të pranishëm! Deshta vetëm me ju përgjigj Vehbisë që tha, është shumë e vërtet e arsyetoj mungesën e barnave mirë, po nuk është faj i QKMF-së, as i menaxhmentit absolutisht as i drejtorisë, sepse Ministria e ke bërë për shkak të festave shpërndarjen me vonesë. Është e vërtet se ka pasur mungesë të disa barnave, mirëpo po e arsyetoj shqetësimin e Vehbisë që tha, me ka dërgu për një ranitall për dhimt. Së pari ranitalli nuk është për dhimt, por, është për lukth, nuk dërgohet asnjëherë pacienti për një ranitall as ne Gjilan as kerkun, sepse ka barna të cilët e zëvendësojnë ranitallin, por, unë jomë shumë e sigurt, se pacienti që është dërgu ka pas ndonjë problem tjetër, që nuk ka mujt mu menaxhu në QKMF, prandaj është mirë të jemi korrekt.

Kryesuesi z.Naim Pira: I falënderoj të gjithë, pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, për mbledhjen e parë të Kuvendit Komunal kemi parapare këtë:

R e n d d i t e

- 1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e dymbëdhjetë e Kuvendit Komunal të Vitisë.**
- 2. Informatë (Raporti) i Kryetarit të Komunës së Vitisë për periudhën janar-dhjetor 2016.**
- 3. Propozim vendim për shqyrtimin dhe aprovimin e Draft Plani Integritetit 2017-2020.**
- 4. Propozim vendim për shqyrtimin dhe aprovimin e Plani të Veprimit për Transparencë në Komunën e Vitisë 2017.**
- 5. Propozim vendim për miratimi e Planit Rregullues të Hollësishëm për Zona Ekonomike me statusin "Parku Industrial" në fsh.Budrik e Epërme.**
- 6. Raporti i punës së KKSB për periudhën Janar-Dhjetor 2016.**
- 7. Propozim vendim për shpalljen e diskutimit publik për Propozim vendimin për rregullimi e komunikacionit në Qytetin e Vitisë dhe territorin e saj.**
- 8. Propozim vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër pronën e paluajtshme të Komunës kompanisë KKDFE SH.A " KEDS" Për vendosjen e një trafo elektrike.**

A ka dikush rreth rendit të ditës? Pasi që nuk ka, unë po e qes ne votim për miratim: Kush është që të miratohet ky rend i ditës me këto pika?

Nga të gjithë të pranishmit u miratuar rendi i ditës

Pika e parë

1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e dymbëdhjetë e Kuvendit Komunal të Vitisë

Kryesuesi z.Naim Pira: Hap debat rreth procesverbalit: A ka dikush ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim? Pasi që nuk ka, po e qes në votim për miratim: Kush është që miratohet pika e parë e rendit të ditës: Konstatohet që me votat e të gjithë të pranishmeve u miratua pika e parë e rendit të ditës.

Pika e dytë

2. Informatë (Raporti) i Kryetarit të Komunës së Vitisë për periudhën janar-dhjetor 2016

Kryetari z.Sokol Haliti: I nderuari Kryesues i Kuvendit, të nderuar këshilltar të Kuvendit Komunal, të nderuar drejtor komunal, ju të respektuar përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, shoqërisë civile, OSBE, dhe organizatave monitoruese të punës së Kuvendit Komunal si dhe ju të nderuar qytetarë të Komunës së Vitisë. Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Kryetari i Komunës e ka obligim që para këshilltarëve të KK-së të paraqes informatën apo raportin vjetor të punës së qeverisë komunale. Prandaj, bazuar në këtë ligj, sot para jush po paraqes raportin vjetor të punës së qeverisë lokale për vitin 2016, si dhe planet që ka kjo qeveri për vitin 2017. Si kryetar komune dhe qeveria lokale edhe gjatë vitit 2016 kemi pas një bashkëpunim të shkëlqyer me të gjitha grupet e këshilltarëve në Kuvendin Komunal, kështu që, me të drejtë pres që edhe ky raport që do ta prezantojmë sot para jush, gjatë kësaj seance, të shoqërohet me diskutime dhe pyetje konkrete që qojnë përpara zhvillimin e përgjithshëm të Komunës sonë. Pasi raporti i punës njëvjeçare të qeverisë lokale, të cilin të shtypur e keni para vetes, është shumë voluminoz, më lejoni të nderuar këshilltarë, që në fjalën time rreth këtij raporti të përmend vetëm disa nga angazhimet kryesore tonat, në mënyrë që t'ju lë kohë juve për diskutime dhe pyetje rreth këtij raporti. Unë si kryetar komune dhe qeveria lokale të cilën e kam udhëheq, parim të punës ka qeverisjen me qytetarët, për qytetarët dhe nga qytetarët, qeverisje kjo që përbën edhe thelbin e një qeverisje demokratike, transparente dhe llogaridhënëse. Prandaj, më gëzon fakti, që çdo vendim dhe punë e jona, deri me tani ka marr legjitimitetin dhe konfirmimin si nga Kuvendi Komunal ashtu edhe nga vetë qytetarët. Kështu që, në fillim sinjerisht falënderoj çdo qytetarë te komunës sonë për mbështetjen dhe bashkëpunimin e ofruar, dhe ju premtoi se mbetemi të angazhuar që ky bashkëpunim me qytetarë të rritet edhe më tepër, në mënyrë që puna jonë të jetë direkt e lidhur me interesat e qytetarëve dhe çdo qytetarë të përfitoj nga puna dhe angazhimi ynë. Krahas bashkëpunimit me Kuvendin Komunal dhe qytetarët, puna jone në vitin 2016 do të ishte e mangët pa kontributin dhe ndihmën e donatoreve dhe organizatave të huaja; USAID, Komisioni Evropian, OSBE, Fondacionin Luksemburg Kosova, DEMOS, etj, si përmes investimeve në projektet e ndryshme ashtu edhe përmes ngritjes së kapaciteteve tona. Pos me donatorë të ndryshëm, qeveria komunale ka pas një bashkëpunim të ngushtë edhe me mediat dhe OJQ-të e ndryshme, të cilat kanë ndihmuar në rritjen e transparencës së punës së institucioneve komunale, ngritjen e brengave dhe nevojave të qytetarëve, si dhe me aktivitete tjera që i shërbejnë interesit të përgjithshëm. Faleminderit për punën dhe kontributin tuaj, njëherë ju premtoj, se unë dhe qeveria ime do të vazhdojmë të jemi në shërbimin tuaj, që puna jonë e përbashkët të përmirësoj jetën e qytetarëve të Komunës sonë. Të nderuar dhe shumë të respektuar këshilltarë komunal, më lejoni, që me kënaqësinë më të madhe t'ju them, se qeveria komunale edhe këtë vit ishte e përkushtuar që të ofroj një jetë më të mirë për të gjithë qytetarët e komunës sonë, të ofroj shërbime më cilësore publike, të rris kualitetin e arsimit, të ofroj shërbime më të mira shëndetësore, të ndikoj në rritjen e mirëqenies së përgjithshme të qytetarëve tanë përmes investimeve direkte në bujqësi dhe përmes

krijimit të një ambienti më të mirë për zhvillim ekonomik, të krijoj një ambient më të pastër për jetesë përmes mirëmbajtjes dhe rritjes së hapësirave të gjelbërta në gjithë territorin e komunës, të zhvilloj dhe avancoj edhe më tutje sportin dhe kulturën, duke ju ofruar mbështetje më të madhe artistëve dhe sportistëve, të mbështesë aktivitetet rinore, pasi të rinjve ju kemi mundësuar kushte shumë më të mira për të shprehur talentin e tyre në gjithë fushat etj. E gjithë kjo punë dhe angazhim është bërë përmes një bashkëpunimi të ngushtë me qytetaret, grupet e interesit dhe kategoritë e ndryshme. Krejt ky angazhim është bërë duke u mbështetur në parimet qeverisëse, të cilat janë dhe do të jenë, si: zbatimi i panegociushem dhe i përpiktë i kornizës ligjore, që rregullon punën e qeverisë komunale, transparenca dhe llogaridhënia ndaj qytetarëve, gjithëpërfshirja e pa rezervë e qytetarëve, këshillave të fshatrave, organizatave dhe grupeve të interesit në çdo hallkë të vendim-marrjes, shpenzimi racional dhe efikas i buxhetit komunal dhe parasë publike, zotimi disiplinë dhe përgjegjësi e çdo shërbyesi të administratës komunale në ofrimin e shërbimeve efikase për qytetarë, kapitalizmi i potencialit të burimeve njerëzore të komunës sonë përmes bashkëpunimit dhe koordinimit të hapur me organizatat e të rinjve, grave, personave me nevoja të veçanta, bujqve, artistëve, sportistëve, studentëve, etj. Bashkëpunim i ngushtë dhe partneriteti me donatorët dhe organizatat e huaja, me qëllim të absorbimit të projekteve dhe investimeve në Komunë. bashkëpunimi parimor me qeverinë qendrore dhe agjensionet dhe mekanizmat në nivel qendror. Puna ime si kryetar dhe e qeverisë komunale gjatë këtij viti është fokusuar në prioritetet si vijon: zhvillimi i Bujqësisë, Shëndetësia, Arsimi, Kultura dhe Sporti, Infrastruktura lokale, Shërbimet Publike, zhvillimi ekonomik, përkujdesja për shtresat e varfra dhe grupet e marginalizuara, bashkëpunimi me shoqërinë civile, donatorët dhe investitorët, mbrojtja e ambientit dhe kualiteti i jetës. Prandaj, më lejoni që shkurtimisht të përmend disa të arritura kryesore në fushat që i përmenda më lartë: Të hyrat, shpenzimet, dhe subvencionet, Komuna e Vitisë gjatë vitit 2016 ka shënuar nivelin rekord të të hyrave vetanake në total, pasi brenda vitit janë inkasuar 954,553.92 €, që krahasuar me vitin 2013 kjo shkallë e të hyrave vetanake është për 286,367.04 € më e madhe. Të hyrat në vitin 2016 shënojnë nivelin rekord në Komunën tonë edhe në inkasimin e tatimit në pronë, pasi gjatë këtij viti janë inkasuar mjete në vlerë prej 377,042.38 €, që krahasuar me vitin 2013 janë për 73,120.40 € më shumë. Ky rezultat është arritur në bazë të rritjes së mirëbesimit në mes të institucioneve komunale dhe qytetarëve, rritjes së kualitetit të shërbimeve për qytetarë si dhe përmes takimeve të shpeshta me qytetarë. Nga të hyrat e përgjithshme komunale, rritje të konsideruar, po ashtu në nivel rekord, ka shënuar edhe inkasimi i tatimit në pronë, në vlerën 377,042.38 €. Edhe pse miratimi i Ligjit për Faljen e Borxheve Publike ka ndikuar në gatishmërinë e qytetarëve për pagesën e tatimit në pronë, prapë se prapë, inkasimi i tatimit në pronë, si e hyrë kryesore e komunës, ka shënuar nivel rekord. Pos të hyrave vetanake, gjatë vitit 2016 kemi shënuar rezultate të kënaqshme edhe në shpenzimet e buxhetit komunal, pasi është shpenzuar 99.33 përqind e buxhetit komunal, e në investime kapitale buxheti i planifikuar është shpenzuar në shifrën prej 99.98 përqind, që do të thotë, se kishim një planifikim të drejtë të buxhetit. Edhe në kategorinë e subvencioneve, gjatë vitit 2016 kishim rritje, pasi për subvencione gjatë këtij viti ishin planifikuar dhe janë shpenzuar 163.002.97 €, që krahasuar me vitin 2013 shkalla e planifikimit dhe shpenzimit të buxhetit për subvencione është më e lartë për 36,404.97 €, mjete këto, që shumica janë ndarë për subvencionim të fermerëve, artistëve, sportistëve, personave që kanë nevojë për asistencë sociale dhe studentëve. Të nderuar këshilltarë. Në vazhdim po mundohem që në vija të trasha të përshkruaj edhe punën e secilës drejtori komunale veç e veç për vitin 2016, e ju para vetës pos që keni raportin detal të punëve të këtyre drejtorive, keni prezent edhe drejtorët komunal, të cilët do të jenë të gatshëm t'iu përgjigjen gjitha pyetjeve që mund të parashtroni lidhur me këtë raport.

Po filloj me Drejtorinë Komunale për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, ku gjatë vitit 2016 janë arritur këto rezultate më të theksuara.

BUJQËSIA: Janë procesuar 1579 aplikacione për subvencione, janë shpërnda subvencione për: makineri, bletari, përpunim të mishit, fidane pemëve, në bashkëpunim me Fondacionin Kosovë Luxemburg. Janë shpërnda fidane të mjedrës për 53 fermerë, janë shpërnda 57 serra, janë shpërnda bimë mjekuese dhe makina bujqësore, janë konfiskuar 154.5 m³ dru dhe janë bërë 306 fletëparaqitje për dëme në pyje, janë shpërnda 77 makina mjelëse për lopë qumështore, vlera 12,320.00, shpërndarja e sistemit të ujitjes për 25 fermerë, vlera 5,799.98€, shpërndarja e koshereve dhe tymtove për 64 fermerë bletarë, vlera 5,338.00€, ndërtimi i serrës tek shkolla e mesme profesionale për nxënësit e drejtimeve bujqësore, vlera: 2,750€. Total investimet në bujqësi 2,194,122.70 €, ndërsa, premtime kanë qenë 1 milion e 100 për katër vit.

ARSIMI: Revitalizimi i 8 shkollave, fillimi i punëve në shkollën fillore në Pozheran, kalueshmëria e testit për klasat e nënta 73.41%, është organizuar me sukses testi i maturës, rregullimi i infrastrukturës nëpër shkolla, fusha sportive nëpër shkolla, organizimi i garave të diturisë, sukseset e nxënësve nëpër gara të ndryshme.

FINANCA DHE ZHVILLIM EKONOMIK: Përgatitja e të gjitha projekteve kapitale, shpenzimi i buxhetit afër 99.33%, inkasimi i tatimit në pronë 101%, finalizimi i Zonës Ekonomike në Budrigë të Epërme, trajnimi i më shumë se 100 bizneseve në menaxhim biznesi, mbështetja e bizneseve për aplikim tek donatorët, mbështetja në hapjen e fabrikës së tekstit nga investitori gjerman (hapja e më shumë se 500 vendeve të punës), mbështetja e investitorëve për investime në komunë, tryeza me diasporën për investime në komunë.

KULTURË, RINI DHE SPORT: Aktivizimi i kinemasë, rifunksionalizimi i sallës së teatrit, hapja dhe aktivizimi i qendrës rinore, subvencionimi i 14 shoqatave, klubeve sportive, etj; shënimi i ditëve me rëndësi dhe organizimi i festivaleve dhe panairove, realizimi i aktiviteteve inovative, si: ekspozita, panairore, punëtori; realizimi i projekteve nga donatorët, themelimi i klubeve të reja sportive, themelimi i Festivalit të Fotografisë.

URBANIZEM DHE MBROJTJE TE AMBIENTIT: Shqyrtimi i 28 kërkesave për leje ndërtimore, shqyrtimi i 21 kërkesave për pëlqim urbanistik, shqyrtimi i 23 kërkesave për kushte të ndërtimit, pastrimi i ambientit në tërë Komunën "Ta pastrojmë Vitinë", shënimi i datave me rëndësi për ambientin (dita e tokës, dita e ambientit, etj), vizita të shumta në terren, plani rregullues i hollësishëm për Zonën Ekonomike, Plani për Hapësira Publike.

SHERBIMET PUBLIKE: Hartimi i Planit të Mobilitetit të Qëndrueshëm, Hartimi i Planit për Eficiencë të Energjisë, rregullimi i ndriçimit publik në qytet dhe fshatra, pastrimi i lumit "Moravë", "Letnicë" dhe prockave, eliminimi i deponive ilegale nëpër fshatra, mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve, mirëmbajtja e kanalizimeve dhe ujësjellësve, sinjalizimi i rrugëve (horizontal dhe vertikal), pastrimi i hapësirave publike në krejt komunën.

SHENDETSIA: Përrurimi i objektit të ri të QMF-së në Pozheran, ndërtimit të ambulantes në Skifteraj, rivitalizimi i kulmit të QKMF-së në Viti, rregullimi i hapësirave tek objektet shëndetësore, furnizimi i QKMF-së me aparaturë mjekësore, shënimi i ditëve me rëndësi për shëndetin publik, organizimi i vizitave nëpër institucione publike dhe lokalitete.

KADASTER, PRONE DHE GJEODEZI: Shqyrtimi brenda afatit ligjor i mbi 13,000 kërkesave për shërbime, avancimi dhe modernizimi i shërbimeve kadastrale, tërheqja e investimeve dhe granateve nga donatorët e huaj (USAID, DEMOS), evidentimi i të gjitha pronave komunale, tejkalimi i realizimit të të hyrave, përgatitja e propozim vendimeve për Kuvendin Komunal.

INSPEKSIONI: Inspektimi i objekteve shkollore dhe shëndetësore, analizat e ujit të pijshëm në të gjitha shkollat, çerdhe, çdo 3 muaj, pranimi teknik, higjiena sanitare të 76 bizneseve të reja,

lirimi i hapësirave publike nga ndërtimet pa leje, inspektimi i kafshëve për sëmundje ngjitëse, inspektimi i bizneseve, asgjësimi i kafshëve të sëmura dhe mallrave të skaduara.

ADMINISTRATA: Shërbime më kualitative për qytetarë, është zvogëluar koha e pritjes për shërbime, ka mbështetur në organizmin e mbledhjeve të Kuvendit Komunal, komiteteve, etj, Janë lëshuar 45,561 dokumente, çertifikimi i 12 zyrtarëve të gjendjes civile.

Në vazhdim do të paraqes në mënyrë telegrafike edhe investimet kapitale, që Komuna e Vitisë ka realizuar nga të hyrat e buxhetit komunal, pastaj në bashkëfinancim me qeverinë qendrore si dhe investimet me donatorë.

Totali i investimeve kapitale

Burimi i financimit	Vlera (€)
Buxheti i komunës	1,727,313.86
Niveli qendror me bashkëfinancim nga buxheti i komunës	3,807,956.59
Palët e treta me bashkëfinancim nga buxheti i komunës	709,518.00
TOTAL= 6,244,788.45 €	

Projektet Kapitale nga të hyrat e buxhetit komunal:

	Projekti	Vlera (€)
1	Ndërtimi i shkollës fillore në Beguncë (faza e II)	184,748.00
2	Asfaltimi i rrugës Sllatinë e ulët Sllatinë e Epërme	93,218.56
3	Asfaltimi i rrugës në fshatin Lubishtë	134,438.75
4	Asfaltimi i rrugëve rurale	372,784.59
5	Rregullimi i rrugëve me zhavor	39,248.80
6	Rregullimi i fushave sportive (Goshicë dhe Ramjan)	24,404.00
7	Rregullimi i rrethojave të shkollave (Remnik, Kabash, Zhiti, Tërpezë)	14,692.56
8	Renovimi i shkollave	48,644.75
9	Ndërtimi i Ambulantes në Skifteraj	24,029.54
10	Renovimi i Ambulanteve	14,792.00
11	Rregullimi i kanalizimeve	130,218.66
12	Ndërtimi i trotuarit dhe ndriçimit publik	145,763.00
13	Rregullimi i hapësirave të gjelbra-publike	20,000.00
14	Renovimi i garazhës të QKMF-së	942.95
15	Ndërtimi i trotuarit dhe hapësirave publike Viti (Demos)	72,201.23
16	Renovimi i shkollës në Smirë	43,888.85
17	Asfaltimi i rrugës Tërpezë-Ballancë	21,820.30
18	Hartimi i projekteve	29,720.65
19	Mbikëqyrja e projekteve	17,467.55

20	Ndërtimi i shkollës fillore në Sadovinë	12,566.79
21	Renovimi i shkollës në Sllatinë e Epërme	4,076.80
22	Restaurimi i shkollës së parë shqipe Stubëll	1,960.80
23	Ndërtimi i trotuarit (nga kisha ortodokse deri te rampa) Viti	13,111.00
24	Ndërtimi i ujësjellësit ne 5 fshatra (CDI)	100,203.00
25	Blerja e veturave për QKMF (Qeveria Japoneze)	56,400.00
26	Rregullimi i argjinaturave te lumit Morava	12,563.15
27	Hapja dhe rregullimi i lumit Morava	9,347.58
28	Bashkëfinancim i bizneseve fillestare (Fondacioni Kos.-Luks.)	34,060.00
29	Projektet e përbashkët për Skifteraj, Budrikë dhe Radivojc (kos-luks)	45,000.00
30	Rregullimi i kuzhinave në shkolla (IADK)	5,000.00
TOTALI= 1,727,313.86 €		

Projektet kapitale të financuar nga donatorët e huaj

Nr.	Projekti	Vlera (€)
1	Verifikimi i pronave Komunale – Demos	5,400.00
2	Aftësitë për punësim rural – Demos	1,200.00
3	Ujësjellësi në fshatin Smirë dhe Vërban – CDI	54,000.00
4	Furnizim me makina për Shëndetësinë - Qeveria Japoneze	56,900.00
5	Zhvillimi i bujqësisë në Komunën e Vitisë – IKC	34,310.00
6	Projekti për tri fshatra nga Fondacioni Kosova Luksemburg	200,000.00
7	Ndihmë për bizneset fillestare – Kosova Luksemburg	136,238.00
8	Shërbime për fermerët e Komunës së Vitisë- IADK	4,100.00
9	Kuzhina te shkolla „ Dëshmorët e Vitisë” – IADK	10,770.00
10	Programi për të drejtat pronësore – USAID	200,000.00
11	Projekti Aftësitë për punësim rural (Helvetas)	6,600.00
TOTALI= 709,518.00 €		

Vlerësimi i punës nga akteret e jashtëm

- Vendi i parë në region për knaqshmëri nga qytetarët për punën, vendi i parë për DKRS në nivel Kosove nga Mozaiku i Kosovës (UNDP, USAID, MAPL), Instituti GAP (përbushja më e lartë e premtimeve nga kryetari në nivel Kosove), shpërblimi nga DEMOS për performancë

Sfidat:

Sfidat që jemi përballur si qeveri komunale gjatë vitit 2016, ishin kryesisht të natyrës financiare, pasi për shkak buxhetit të limituar kanë mbet të realizohen projektet:

- Shkolla fillore në Pozheran, Rregullimi i lumit “Morava” me proçkat përreth, mungesa e pronave komunale për zhvillimin e bizneseve, implementimi i Planit Zhvillimor Komunal dhe Urban, uji i pijshëm në Sllatine të Epërme, Sllatinë të Poshtme, Sodovinë Jerlive, Sodovinë Çerkezëve, Terstenik, Smirë, Vërban, Zhiti, Skifteraj, Beguncë. Por, këto sfida në bashkëpunim me nivelin qendror dhe me donatorë tjerë tani më kanë filluar të zgjidhen, pasi ka nisë ndërtimi i objektit të shkollës fillore në Pozheran, pastaj është duke u punuar në vazhdimësi për rregullimin e lumit “Morava” dhe përroskave tjera, si dhe janë para përfundimit edhe finalizimi i punëve rreth projekteve për sigurimin e ujit të pijshëm në: Sllatine të Epërme, Sllatinë të Poshtme, Sodovinë Jerlive, Sodovinë Çerkezëve, Terstenik, Smirë, Vërban, Zhiti, Skifteraj, Beguncë

Të nderuar këshilltarë të Kuvendit Komunal, unë si kryetar komune dhe qeveria lokale, krahas tejkalimit të sidave që na janë paraqitur në vitin 2016, ju pretoj se do të angazhohemi që edhe premtimet tjera që kemi dhënë për qytetarë ti realizojmë. Këtë mund ta arrijmë vetëm nëse punojmë bashkë ashtu siç kemi punuar deri më sot. Ju faleminderit për vëmendje dhe tani jam i gatshëm që t’u përgjigjem gjitha pyetjeve të juaja rreth këtij raporti.

znj. Vjollca Kadolli-Halili: Informata apo raporti i kryetarit, të cilin raport e kemi para vete, i cili raport na ka ardhur ne seancën e parë tregon edhe njëherë për përgjegjshmërinë e kryetarit dhe qeveris komunale para qytetarëve dhe këshilltarëve komunal dhe vërteton respektimin e Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale. Kjo informatë paraqet punë njëvjeçare të institucioneve komunale dhe nga ajo që shihet këtu tregon për një punë dhe rezultate impresionuese për qytetarët e Vitisë. Përformanca e të gjitha drejtorive ka qenë shumë e lartë gjatë vitit 2016, por, veçoj disa nga drejtorit. Drejtoria e Bujqësisë, ku përpos obligimeve të tjera ka bërë edhe subvencionimi dhe përkrahjen e shoqatave të ndryshme, të cilat janë paraqitur në mënyrën analitike edhe në këtë raport. Te Drejtorin e Shëndetësisë, përmes rritjes së inkasimit, përmes të hyrave si dhe rritjes së kualitetit të shërbimeve shëndetësore përmes përfitimeve të donacioneve të ndryshme, që ka ndikuar edhe drejtpërdrejt në rritjen e kualitetit. Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim, vlen të theksohet inkasimi i të hyrave vetanake, që ka qenë në nivel shumë të lartë, ka qenë shumë i kënaqshëm si dhe realizimi i shumë projekteve të ndryshme, në bazë të asaj që kemi pa në teren është përfshi tërë territori i Komunës së Vitisë. Te Drejtoria për Kulturë, Rini, Sporte, përpos performances së lartë që ka treguar në aktivitetin e ndryshme, ka bërë edhe subvencionimin nga buxheti i saj të klubeve sportive, shoqërive të ndryshme si dhe për individ të caktuar. Duke pasur parasysh të gjitha këto të cekura me lartë, pa harruar edhe vendime dhe rregulloret e Kuvendit Komunal dhe konfirmimin nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, për ligjshmërinë e tyre, pastaj marrëveshjen dhe bashkëpunimi me organizatat e ndryshme dhe donatore e ndryshme, ku kemi edhe një numër të donacioneve në këtë vit, përformanca e juaj kryetar, por, edhe e qeveris komunale, ka qenë shumë e lartë, kjo është dëshmuar edhe me renditjen në vendin e parë në nivel shtetëror nga organizatat e ndryshme për realizimi e punëve në teren.

znj. Mirlinda Sadiku: Kamë një qip, që kërkoj nga Zyra e Informimit për një asistim, ku në këtë qip kam disa foto.

Pas një diskutimi për këtë qip u lejua që qipi të vendoset

znj. Mirlinda Sadiku: E filluam vitin 2016 me harrimin e asfaltit në Tërpezë, gjendja ka qenë siç shihet ne fotot, nuk e di a është penalizu ky operator ekonomike që i ka kry këto punë. Prapë jem te Tërpeza, te prerja e pyllit, e sipas Ligjit nr. 03 L/153, i datës 29.03.2010, neni 18, kompetencat e deleguara të Komunës, mbrojtja e pyjeve që ndodhin në territorin e Komunës, në kuadër të autorizimeve nga autoriteti qendror, duke përfshirë edhe dhënien e licencave për prerjen e drunjtëve në bazë të rregullave, sepse gjatë dhënies së licencave, detyrimisht duhet të përmbahen kriteret e paracaktuara. Kryetar, nëpër parcelat të cilat janë private, ku kultivohen kultura bujqësore është vënë shiriti i shumë puseve nëpër fusha, mirëpo shume pak mos me than hiq, është punu edhe ne sistem te ujitjes, është për lakmi me ja marrë Komunës se Rahovecit, e cila i ka investu dikun rreth 94 mijë euro nga buxheti komunal, 160 mijë nga Ministria e Zhvillimit Rural. Kryetar, ende nuk është bë zgjidhje për gropat septike, shume kanalizime derdhen në sipërfaqe te hapura, prroka, si p.sh.: ai i Smirës, që derdhet ne Drobesh, lagjja Tërziu, mendje ka që njerëzve ju hin uji edhe nëpër bunarë, e d.m.th ata bunarë janë jashtë funksionit, njëjtë e ki gjendjen në Drobesh, Skifteraj, etj. Objekti i Drejtorisë së Bujqësisë ka mbet në gjendje qysh ishte me herët, edhe pse përkundër asaj që ke thanë, që mendohet të behet muze, ka rrugë në Viti që janë shtru asfalt mbi asfalt, por, në Komunën e Vitisë kisha potenc, p.sh.: aty te rruga e “UÇK-së”, rruga “17 Shkurti” në fshatin Skifteraj, pastaj në Podgorcë si dhe është një lagje në fshatin Kabash, ku aty është një person me aftësi të kufizuar, për hirë të ruajtjes se anonimitetit inicialet e tije janë J.J., i cili çdo ditë përballet d.m.th, duhet ta kaloj rrugën me karrocën e tij në kushte shumë të këqija. Kryetar, për tri vite qeverisje, vetëm njëherë keni nda subvencione, bursa për studenta. Kryetar, a e din se çfarë uji konsumojnë fëmijët tanë nëpër shkolla. Sipas një raporti që e kam kërkuar nga Drejtoria e Inspeksionit, për çka i falënderoj qe me kanë kthy përgjigje edhe në afat rekord, del se uji jo i pijshëm është në aspektin kimikofizik dhe bakteriologjik jane në fshatrat Ramnisht, Ramjan, fshati i Ri, Germovë, Buzovik, Stubell e Epërme, Sllatine e Ultë, Budrikë dhe Zhiti, uji është i kontaminuar, kurse ne aspekti bakteriologjik janë shkollat Tërpezë, Qifllak, Ballancë, Sadovinë e Jerlive e Qerkezve, Podgorc, Binçë, Kabsah, Debellde, Skifteraj, Devaje, Viti, në të dy shkollat e mesme, Sllatinë e Epërme, në kohën kur është bë testimi nuk ka pasur ujë, d.m.th kërkoj, janë në aspektin bakteriologjik të dëmshme për fëmijët tanë. Pra, vetëm në nëntë shkolla pijet uji, shifet edhe nga fotot, se objekti i shkollës se mesme profesionale, e dimë që nuk është investim i komunës, duhet te jemi real, mirëpo pranimi teknike u bë prej Komunës, këtë ma ka thënë drejtori i Arsimit z.Qahil Sinani, ku ka thanë se pranimi teknik është be vetëm i objektit shkollore, por, jo edhe i sallës, mirëpo nuk e di qyshe është bë një pranim teknik, tu e pa gjendjen e klasave dhe gjendjen e korridorit, madje madje ka edhe te kabllot elektrike që mundet me paraqit rrezik për jetët e njerëzve. Po ashtu edhe djegien e ati objekti. Shpeshherë kemi insistu mu formu ajo kopani për mbledhjen e mbeturinave, sepse, ato investime që po bëhen me qindra mira euro, çoftë kanalizim, çoftë ujësjellës, me ja dorëzu dikujna me kërku prej dikujt përgjegjësi prej tyre. Po e dimë që kemi gjendje të keqe, sidomos ne Viti, p.sh.: te menaxhimi i mbeturinave, Kryetar, procesi i emërimit te rrugëve ende nuk është përmbyllë ne Viti, e kam cek edhe me herët, në disa komuna të tjera Shtimja, Deqan, mandje kanë fillu me i vendos edhe numrat se leje ma emrat, e te na ka mbet si pezull. Qysh ka than kryesuesi, dikune janë rreth 64 ankesa, po ashtu sipas fjalëve të kryetarit të sindikatës z.Kemajl Bislimi, i cili ka thënë se 39 pensionista e kanë paditë Komunën për shkak se nuk është apliku kontrata kolektive me ju pagu tri pagat e fundit. U proklamum shumë për fabrikën e tekstilit, ka shumë njerëz që po pyesin, se çka po ndodh me ta, pse nuk po fillon, cili është problemi. Sa i përket investimeve, duhet te ju thuhet qartë qytetarëve të Vitisë, se shuma prej 4 milion e 474 mijë euro është e parapamë për Komunë të Vitisë prej viti 2016 deri ne vitin

2019, ajo çka me ka ra ne sy, këto janë informatat te marra të sakta prej faqes zyrtare te Ministrisë së Financave, faktikisht buxheti që është aprovu tash para vitit te ri, ku aty thuhet salla, palestra sportive 900 mijë euro, dyshoj që ka mu plotësuar standardi.

Kryetari z.Sokol Haliti: Në Tërpezë, unë e kam bërë si komunë ndalimin e prerjes se atyre druve dhe se bashku me komunitetin e Tërpezës, por, kompetencat nuk i ka pas Komuna, kompetencat kanë qenë të nivelit qendror, por, kjo nuk do me thënë që ne mos te intervenojmë. Po flet për shkollën e mesme, një shkollë që e ka ndërto ministria ajo e pranon edhe teknikisht, por, i kame obligimet që edhe një viti ministria mu kujdes për at aspekt edhe operatori, këto gjera janë te rregulluara me ligje, ne kemi qenë vetëm me e përshejtu ndërtimin e saj dhe përmbarimin, për shkak se pesë vite u bërë histori dhe këtë ja kemi arrit. Unë kam qenë në dijeni edhe rreth mbushjes se atyre ujërave rrjedhëse, e përgëzoj drejtorin e shkollës, i cili edhe vet është angazhu se bashku me korrilat. Këshilltare, është mirë ju kur ti merrni informacionet me i marr mirë e jo vetëm me dal me fol pa pas informacione, se kjo rrugë është në përgjegjësi të Ministrisë së Infrastrukturës, qytetaret e Vitisë janë tu e pa përpjekjen e kësaj qeverie që tri vite, ti sa dush qit foto qytetaret, janë tu e pa punën e kësaj qeverie. E di që nevojat janë shumë të mëdha, por, ne kemi bërë riparim hixhenosanitar në Gushicë, në shkollën e Sllatinës, te shkolla e Sllatinës se Poshtme, e shume shkolla tjera. Kemi nevojë ujin e pijes me e pas me standarde, inspektori sanitar duhet te jetë shumë më aktiv, Drejtoria e Arsimit do te jete shume me aktive, por, nuk është që nuk kemi bërë edhe shume te uji i pijes, por, pse nuk po i përmendni punët e mira çka janë bërë ne shumë shkolla, mirëpo kadal dal kemi me i merrri krejt, të gjitha me i rregullu.

znj.Mirlinda Sadiku: Ai investim që behet le të bëhet afatgjatë. Shkolla 2 milion euro me të pikë, mu detyru me i hek nxënësit prej aty me i qu me një klasë tjetër. Kryetari, ti e dinë shumë mirë që e ki prish at aneksin e shkollës, që ka investu kapanamuri me shume se gjysmë milion marka, atëherë i ki thy ato makineri, unë jam kanë skeptike. Kur ka ardhur atëherë drejtori i Arsimit, kam qenë shume skeptike, ato makineri janë jashtë funksionit, ajo shkollë ju ka vnu dryni prej inspeksionit të Ministrisë së Arsimit tri herë, se kane vluar ujërat e zeza, unë krejt çka po kërkojnë qe qaj investim që behet le te jete afatgjate e jo arno sot arno nesra.

Kryetari z.Sokol Haliti: Ne po diskutojmë për raportin 2016 e jo për të ardhme. Ndëgjom këshilltare, desh flasim edhe për planifikimet e 2017, unë kam thanë edhe po te thamë që 2016-ta është viti me i suksesshëm në 50 vitet e fundit për Komunën e Vitisë, sa i përket makro investimeve, me shifra, me fakte po të flas, por viti 2017 ka me qenë edhe me i suksesshëm, atëherë flasim prapë, por, ti po flet për një projekt që e ka realizu Ministria e Arsimit, e po flet për 2009-2010, ku ka filluar ai projekt, prandaj, nuk po e gjanë adresën këshilltare, ti po ma livdon at gjendje qyshe ka qenë atëherë e po ma livdon, apo do po ta kthej edhe shoqatën e gjuhëtarët aty qysh ka qenë.

z.Samet Idrizi: Faleminderit kryesues, e falenderoj kryetarin për ofrimin e informatës/raportit vjetor, unë kam disa pyetje. Kisha fillu me faqen numër 10, të hyrat 2013-2016, ku bëhet një krahasim i vitit 2016 me vitin 2013, çka nuk mund të qëndron si krahasim legjitim, ngase që ne e dimë që ka pas një falje, një amnisti te përgjithshëm për borxhet publike dhe sigurisht se borxhet publike kanë ndiku në një rritje me te madhe krahasuar edhe me vitin 2015, mirëpo është opinion i imi që ne raportet e tjera të behet krahasimi vetëm për vitin paraprak, p.sh.: nëse e krahasojmë vitin 2015 të kësaj qeverisje lokale me vitin 2013, del si njëjtë, gati është 308 mijë me 303 mijë 3921 euro, kështu që, krahasimi nuk mund të qëndroj kështu siç është shënuar. Te faqja 14 e këtij raporti, ku thuhet se incistimet kapitale janë dikund 7 milion ose është gabu ose janë qit disa projekte te cilët veç janë ne fazën iniciale, sa janë nënshkruar nuk e di, disa a ja kanë fillu a jo, palestra sportive 900 mije euro. Unë po kërkoj mu bërë një raport me real, se ajo që është bërë ajo

dukët, ajo u bë tash, krejt na e shohim e prekim atë që u bë. U përmend, që Komuna e Vitisë është shpall me performancën më të mirë, nëse është me te vërtet kështu është ne rregulle, mirëpo ne pjesën e auditimit të jashtëm, Komuna e Vitisë ka dal ne mesin e tri komunave te kualifikuara me keq, është mirë kryetari mu bë real edhe me thanë, na kemi dal me performancë, mirëpo mungesën e auditimit jemi keq, auditori i brendshëm duhet të jetë në nivel te detyrës, sepse auditori i brendshëm është ai i cili, d.m.th ato mangësitë që shfaqen gjatë punës se përditshme mundet deri ne fund te vitit, bile ka kohë deri ne fund të janarit me i përmirësu shumë gjëra që kur të vjen auditori i jashtëm me pas sa me pak parregullsi, auditori i jashtëm, Komunën e Vitisë e klasifikon keq, te përcjellja se punëve, mbarëvajtjes, respektimit të ligjeve, rregulloreve, udhëzimeve, Kryetari ka bë një raport ne vija te trasha edhe te Zyra e Prokurimit Publik, ne mujmë me kërkun një raport edhe me detalish prej Zyrës së Prokurimit. Këtu, unë e pash që i ka shënu dhe i ka qit mirë subvencionet, ku janë bë qyshe janë bë në Drejtorinë e Kulturës dhe të Bujqësisë, edhe këtu ka qenë mirë me i listu listën e operatorëve ekonomik, kontraktorëve, të cilët kanë arrit me e marr kontratën në Komunë të Vitisë, e ka pas bajagi shumë, ku për herë tjera është mirë me ditë. Faqe 27, te interpretimi ligjor për dhënie, adoptimin e një zyre për barnatore brenda QKMF-së ne Pozharan. Kam pyetje: Kjo a është barnatore kuadër të QKMF-së si publike, apo mendohet ti jepet dikujt me qira? Unë mendoj që nuk është mirë me fut barnatore në ambulatë qysh është fut me herët edhe kafiteri në shtëpinë e kulturës, mu me ka brengos kjo kur u fut atëherë, por, edhe tashti unë jam kundër kësaj. Faqe 38. Unë e di që janë subvencionu shumë OJQ, organizata të tjera, mirë është kjo, ka pas edhe rezultate, po me intereson numër 18, OJQ-PMSC, është subvencionu dy herë, ku 4000 euro njëherë, 2100 njëherë, nuk e kam të qartë, cila është veprimtaria e saj.

z.Daut Xhemajli: Përshëndetje për te gjithë juve! Është një raport mjaft i gjerë, është vështirë të thuhet për këtë kohë krejt ato që janë bë ose ato që kanë mbet pa u bë, mbi gjitha do te fokusohem te vërejtjet, pa i mohuar ato që janë bë në këtë Komunë, e kame fjalën ne fillim te të hyrat vetanake. Kjo komunë, unë mendoj që nuk mundet mu krenu me te hyrat që i ka pas në tatimin në pronë, sidomos, sepse as planifikimi për vitin kalendarik nuk është arrit e leje ma tu e pas parasysh borgjet e akumuluar, tu i pas parasysh rrethanat që kanë ndiku, falja e borgjeve, unë mendoj që kjo ka qenë dashur të jete e dyfishuar e leje ma me qenë kështu, po në këtë segment asnjë fjalë nuk është thënë për sfidat ne këtë sektor, për problematikat ne këtë sektor dhe hapat që duhet eventualisht me i marr dhe që duhet mi përmirësua kjo, se edhe këtë viti kemi me pas vazhdim te faljes. Faqe 13, kam prit që se paku ne raport përfundimtar të kryetarit ti kemi specifikimet lidhur me disa projekte që janë kry, p.sh.: rrugët rurale, specifikim cilët rrugë janë kry me detaj, titullimi i projekteve të përgjithshme; rregullimi i kanalizimeve, me u cek cilat janë ato projekte që janë kry; rregullimi i hapësirave publike etj. Në këtë kuptim kame prit se paku tash te kemi një informatë me të detajuar, një informatë që unë mendoj që duhet te hiqet nga ky raport, është punët e pa kryera për projektet e pa kryera, sidomos bashkëfinancim me nivelin qendror. Nuk e di a është harru apo çka, por, ne këtë raport nuk është përfshi projekti i pastrimi te shtratit te lumenjve nga Ministria e Planifikimit, më doket 84 mije e 683 euro, nuk është thënë në projektet e financuara, nuk është thënë as ne tabelë si shifër që është financu në Komunë, mendoj që kjo duhet te cekët ne raport. Lidhur me punën e organeve komunale, unë mendoj përveç përshkrimit te punëve, që është thënë diku është përshkru qaq gjatë që nuk ka kuptim, p.sh.: Lektor, Zyra Ligjore, etj, d.m.th i përshkruan krejt vendimet që i kanë këqyr, i kanë lexu, nuk mendoj që është dashur mu bë kjo. Te Njësia e Auditimit, shumëçka është thënë për punën, por, nuk është thanë asnjë fjalë për rekomandimet dhe gjetjet e auditorit, dhe cilat janë kanë vështirësitë e komunës, me u ballafaqu me atë dhe me i zbatu planin e zbatimit te atyre rekomandimeve, por, edhe te auditorit te përgjithshëm. Unë mendoj, që ky raport duhet me u plotësua me të, në mënyrë që me pa kjo Komunë, se çka ka pas rekomandime

dhe çka ka marr për zbatimin e atyre rekomandimeve. Unë kam kërku njëherë, që në faqen e komunës ti kemi përshkrime e vendeve të punës. Zyra e Personelit në këtë drejtim asnjë hap nuk e ka bërë, përveç atyre dy përshkrimeve që janë bërë, as nuk kemi sistem të saktët, d.m.th te evidentimit, nuk kemi asnjë plan të trajnimit të këtij stafi, asnjë fjalë nuk është thënë për ato kontratat në vepër, për njerëzit që merren, mendoj që është dashur me u thënë, asnjë shifër nuk e kemi prej tatimit në pronë, sa janë borgjet e akumuluar të të gjithë qytetarëve deri në këtë vit.

z.Ali Bajrami: Përshëndetje Kryetar, Kryesues, Nënkryetar e ju të pranishëm! Para se të lëshohem në këto shifra, është shumë me rëndësi të dimë, se qyshe e lexojmë qyshe i interpretojmë këto shifra që i kemi para vete. Nëse hymë edhe e zbërthejmë te investimet kapitale, që i kemi 1 milion e 570 mijë euro, në si Komunë kemi dikun 3 milion e 800 mijë nga investimet grande qeveritare dhe 700 mijë euro donator të tretë, që shuma totale është 6 milion e 244 mijë euro. Nuk kemi çka flasim, shifrat flasin vetë. Gjatë vitit që po e lëmë pas, që është një vit shumë i suksesshëm, janë bërë shumë pune të mëdhaja në nivel të komunës edhe për qytetaret e Komunës së Vitisë. E përgëzoj kryetarin, drejtorët dhe juve të gjithë asamblistëve që kemi kontribu për këtë.

z.Bekim Azizi: Me preku fjala e kryetarit, që tha, na mos të dalim jashtë rrugës së popullit, le të del. Thave ndoshta u kanë i pëmë ai që ka dal jashtë rrugës, e di saktësisht se nuk u kanë i pëmë, se qaty e ka shpënjën ai, e di saktësisht se ka dal prej shtëpisë, por, ura aty është 2 metra e gjanë në Ballancë ku ka ra prej urës. Shkolla teknike, e vjetra, ose e shpallim muze ose e rregullojmë, se aty i kemi diku 10 punëtorë që punojmë na hala, punojmë qaty, nuk ke dal asnjëherë me na vizitu, hajde këqyre qysh i kemi ngre kabllot prej orës se rrymës për me e leshu një makinë me punu, 70 euro kanë kushtu qato kablla, tre muj ditë për qato 70 euro edhe nuk i keni siguru, menxi që e kemi siguru prej shkollës, hajde këqyr qyshe i kemi ato kablla që vyen për me punu me makina na që punojmë me nxansa, hajde përcjelli dritaret qyshe janë atje, janë stufat e moçme ende, ka nevojë mu investu në këtë shkollë, se na duhet. Gjashtë milion investime po thotë, ku është palestra sportive që e ki shkru këtu, që po e llogaritë, hajde shkojmë e këqyrmi ku është 1 milion e 397 mijë e 508 euro, ndërtimi i shkollës fillore në Pozheran, hajde shkojna e këqyrmi ku është shkolla fillore që po thu e kame maru 2016, se je tu kallzu raport te 2016, hajde shkoj e këqyrmi ku është renovimi i shtëpisë së kulturës 309 mijë euro. Ti po thu raporti i 2016-ës, ti po thu u kame bërë 6 milion investime, po hajde shkoj e këqyrmi ku janë qato, mos bani hajgare, qat shifër që e shkruani bile shkru me përgjegjësi. Hajde shkoj i këqyrmi dritat në Smirë që i ki pagu, ku janë, hajde shkojmë i këqyrmi kanalizimin 400 mijë euro që është a është kry, hajde e këqyrmi rrugën e Tërpezës, hajde shkojmë e këqyrmi në ambulante a ka ranitoll, kanilla, hajde shkojmë i këqyrmi ndërtimet pa leje ku i ki, ndërtesa pa leje te rruga “UÇK”, e ki pompën e benzinës, që e ki dhënë leje, që është maru te stacioni i autobusëve.

z.Bislim Bislimi: Është normale me kritiku, por, sa normale mos me e pranë kritikën. Kryetari më së pari nuk është fer me thanë që në fillim, si vetëvendosje të kemi përkrah, por, pasi që ki dal ki rrëshqit prej projekteve ma nuk te përkrahemi, populli është tu vuajt edhe po te thamë 80% janë tu vuajt, 20% ndoshta janë të kënaqte deri dikun nja 2% janë pasuruar, se nuk ka shtet, se po te ketë shtet, unë i kisha propozu, që kryetari i Komunës te jete i përjetshëm edhe kurrë mos te del prej aty njëherë le te ngopet edhe ma kurrë nuk ka me pas nevojë. Në po themi se shërbimet shëndetësorë nuk janë mirë, me vjen keq që koleget tona nuk i thonj këto probleme. Në të gjitha këto përpjekje a kemi be plan ku nja 10% janë të hendikipuar, me te meta fizike qka keni nda për ata njerëz, a keni be diqka per 18 vjet komuna e Vitisë për familjet e dëshmorëve, invalid të luftës, luftëtar sa ka dhen Vitia.

znj.Selvije Rexhepi: Përshëndetje për te gjithë! Unë kisha dash ta jap një vërejtje te projektet kapitale, të financuara deri sa këtu është një vlerë prej 3 milion e 8700 mijë, disa projekte që janë

në proces të implementimit, d.m.th që për 2017 do të hapen procedurat e tenderimit, ma merr mendja që nuk është dashur të paraqiten, se ne po flasim për 2016, dhe puna e kryetarit, kjo vlerë që nuk është dashur të paraqitet e ka vlerën diku 2 milion 6700 mijë. Nuk kanë qenë mirë të paraqiten, sepse, procedurat do të jenë në vijim e sipër, shume rregullore janë miratu, që janë dashur të implementohen në 2016 dhe 2017, ato kanë një kosto financiare, a ne fakt nuk janë në harmoni me buxhetin. Unë kam bërë një paralogari të të gjithë atyre rregulloreve që janë miratu, që mund të arrin afër 800 mijë euro vlerën. Dëshiroj ta pyes kryetarin: Ju edhe drejtoritë tuaja, a kanë ndonjë sfidë në realizimin e punëve të tyre, me përjashtim nja dy drejtorive tjerat, asnjëherë ne raportet e tyre nuk kanë paraqit që ballafaqohen me sfida për punët e tyre? U përmend nga kryesuesi, që është një grup ne kuadër të grupit të grave këshilltare, po bashkëpunimi juaj ka qenë falënderues kryetar me këtë grup, por, është dashur të paraqitet si bashkëpunim i juaji, se është bërë një punë e madhe nga ky grup. Te Drejtoria e Bujqësisë, ka pasur investime, ka pasur donacione të ndryshme, mirëpo një meritë të madhe e ka edhe grupi lokal i veprimit “Vitia”, çdo marrëveshje, çdo kontratë që është shkru në bashkëpunim me ato organizata, si: ELVETAS, GIZ etj, ka qenë edhe grupi lokal i veprimit “Vitia”, nuk është përmend në asnjë rast ky grup, është paraqit vetëm me një rast mua me vjen keq që drejtori e ka lëshuar at gabime.

z.Ekrem Abazi: Përshëndetje për te gjithë te pranishmit! Dashta të them një fjali për investimet kapitale që janë bërë gjatë viti 2016. Me të vërtetë viti 2016 për Komunën tonë ka qenë një vit që janë bërë shume investime kapitale në infrastrukturë, shumica janë bërë shumë me vend, por, kam një kërkesë për kryetarin, që gjatë vitit 2017 të jetë me i rreptë ndaj punëkryeseve e sidomos ndaj atyre që i mbikëqyrin projektet. Po kryhen, paret po shkojnë e punët në disa vende nuk janë kry qyshe duhet. Vërejtjen më të madhe e kam të mbikëqyrësit.

Kryetari z. Sokol Haliti: Do të përgjigjem në pyetjet e parashtruara, për te hyrat 2013-2016. Normal kemi bërë krahasim, shumë normale është mu bërë krahasim prej asaj qeverie dhe prej kësaj qeverie dhe kemi dal shumë pozitiv. Shumë më shumë që kam prit edhe vete përformanca, natyrisht e kanë vlerësuar të gjithë, të auditimi, faktikisht baza ligjore me statut të komunës i raporton Komitetit për Politik dhe Financa dhe ju i keni përfaqësueset te gjithë aty. Palestra sportive është memorandum 1 milion e gjysmë, nuk është 900 mijë euro. Te subvencionimi i OJQ-ve, natyrisht ne po vazhdojmë me i subvencionu, janë rrit subvencionimet e do të vazhdojmë. Te barnatoret, ju e dini që barnatoret i kam gjetë në QKMF. Të hyrat vetanake, te tatimi në pronë, mu më ka gëzu fakti, për shkak te këtij ligji që është miratu për faljen e borgjëve, se arritëm 101% tatimin në pronë, nëse mujmë me shumë, a ka vend aty për përmirësime, ka vend, duhet me formu një grup punues me shiku edhe ndoshta ka vende, projektet që i përmende vetëm duhet me i klasifiku, projektet e nivelit komunal, duhet bashkëfinancimet e komunës me nivelin qendror, bashkëfinancimin e komunës me donator dhe projektet e nivelit qendror apo donatorëve që kane bërë veçmas dhe janë projekte dyvjeçare, projektet e palestrës, projektet të shkollës së Pozharanit janë ne vijueshmëri. Te shkolla teknike, e kame vizitu shumë herë, por, nuk e di a ishe ti aty a jo, unë ti tregoj argumentet që kam qenë shumë herë në vizitë aty, duhet me investu te ajo shkollë, unë e kam ngrit zërin edhe për rrymë, momentin që filluan redukimet për rrymë në Viti, unë si kryetar i Komunës e ngrita zanin dhe e thirra nivelin qendror të KEDS-it në Prishtinë. Ne edhe për barna do te veprojmë njëjtë. U përmenden edhe të hendikepuntë, ne i kemi bërë pjerrinat për ta, ne i kemi ndihmu, kemi bërë vendim për Hendikosin, shume aspekte që nuk janë bërë nuk i ki në raport. Kemi bërë vendim për familjet e dëshmorëve, vendimi për veteran, ju kemi ndihmu, i kemi përkrash edhe shoqatat e grave, mirëpo në këtë raport nuk kemi mujt me i fut të gjitha. Mbikëqyrja ndaj mbikëqyrëseve të projekteve do te jete me e fortë, më e mirë, më kualitative.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, ju faleminderit kryetar e ju te gjithë që dhatë kontributin e juaj. Janë bë mbi katër ore që jem tu diskutu, unë po mendoj një ore ta kemi pauzë dhe të kthemi prapë me punë. Fillojmë me punimet e seancës së parë pas pushimit të drekës.

Si pikë të tretë të rendit të ditës kemi:

3. Propozim vendim për shqyrtimin dhe aprovimin e draft planit të Integritetit për vitin 2017 – 2020

Unë fillimisht ja kisha dhanë fjalën nënkryetarit të komunës, që në pika të shkurtra të na informoj rrethë këtij draft plni

Nenkryetari z. Hasan Aliu: Para jush e keni draft planin e integritetit 2017-2020, unë fillimisht po ju tregoj për historikun e hartimit të këtij plani dhe prandaj kam edhe një propozim. Fillimisht kryetari e ka formuar një komision me vendim për hartimin e planit të integritetit, në bashkëpunim me ju, e keni grupin dhe e keni edhe metodologjinë se si është përdorur për me ardh deri te ky plan, kanë qenë edhe me një puntori, punë dyditore në Sharr anëtarët që kanë qenë të zgjedhur nga ana e kryetarit dhe është ardhur deri te ky plan apo akt final, të cilin e keni para jush. Megjithatë unë kam qenë personi kontaktues që kam bisedua me përfaqësuesit e UNDP-së, por, në pamundesi, se ata kanë qenë në pushim për shkak të fundvitit dhe ne e kemi procedu edhe në KPF, me çka edhe aty ka pasur shumë vërejtje lidhur me draft planin, të cilin e keni para jush dhe pas dërgimit të materialit juve, pra, unë kam biseduar edhe me përfaqësuesit e UNDP-së, me çka kanë ra edhe ata dakord, që kjo pikë e rendit të ditës me lejen e juaj kuptohet të shtyhet për në seancën e muajit shkurt, në mënyrë që komisioni i cili është i formuar nga ana e kryetarit ta merr edhe njëherë dhe të gjitha ato lëshimet që janë bërë të përmirësohen dhe të kthehet për miratim në seancën e ardhshme.

Kryesuesi z.Naim Pira: Sidoqoftë, unë po e hapi debatin rreth kësaj pike të rendit të ditës.

z.Sami Demelezi: E tha edhe nënkryetari komunës, se si ka ardhur deri te ky plan i integritetit. Për mua një plani i integritetit në kontura të përgjithshme i punuar mirë, i ndarë në tre kapituj, në dy kapitujt e parë janë paraparë rreziqet e mundshme, ndërsa në të tretin janë dhënë masa të cilat duhet marrë. Mirëpo, jo vetëm sipas meje, po atë ditë edhe në KPF, edhe diskutuesit e tjerë kishin vërejtje të shumta në brendi, në veçanti në dy kapitujt të parë, prandaj, në emër të grupit të këshilltareve të LDK-së, jam që të shtyhet për seancën tjetër.

z.Daut Xhemajli: Unë rreth kësaj pike, normalisht se ka pasur vërejtje të shumta në KPF, edhe e kemi deligua në Kuvend, por, tu pasur parasysh që ka aq shumë vërejtje, që është vështirë me i inkorporua në këtë draft plan, unë e mbështes propozimin e nënkryetarit, që kjo pikë të kthehet në rishqyrtim e jo të shtyhet, dhe të filloj edhe një herë procedurat, në mënyrë që të përmirësohet, sepse, ka shumë që duhet me u përmirësuar, në mënyrë që të jetë ma i kapshëm një plan i integritetit edhe ndoshta ta kemi në të ardhmen personin që ka me u mirr me këtë, në mënyrë që adresimi i krejt këtyre çështjeve që kanë të bëjnë me integritetin e institucioneve tona të jetë ma konkretë.

Kryesuesi z.Naim Pira: A ka dikush tjetër rretë kësaj pike? Pasi që nuk ka, unë do ta qes në votim që të kthehet edhe një herë në rishqyrtim kjo pikë e rendit të ditës, me vota unanime shkon kjo pikë edhe një herë për rishqyrtim.

Si pikë të katërt të rendi të ditës kemi:

4. Propozim vendim për shqyrtimin dhe aprovimin e Planit të Veprimit për Transparencë në Komunën e Vitisë për vitin 2017

Ftoj që këtë pikë para jush ta prezantoj përfaqësuesi nga Zyra për Informim

z.Mustaf Mehmeti: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun ka nderin që para jush të prezantoj planin e veprimit për transparencë për vitin 2017. Ky plan bazohet në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës së Vitisë, si dhe Rregulloren Komunale për Transparencë, që është aprovuar vitin e shkuar nga Kuvendi Komunal Vitisë. Plani në fjalë, ka për qëllim pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje dhe sigurimin e punës sa më transparente në institucionet komunale të Vitisë. Plani përbëhet nga 13 objektiva kryesore, që i keni të plasuar në materialin që e keni pranuar nga sekretaria e Kuvendit Komunal të Vitisë. Në fund të këtij plani gjenden edhe aktivitete që do të ndermirren për realizimin e saj, personat përgjegjës për zbatimin e objektivave të parapara si dhe afatet ligjore për zbatim të saj. Krejt në fund e keni të paraqitur edhe orarin e konferencave të rregullta për shtyp që do të mbahen nga drejtorët e drejtorive, kurse pas konferencave të parapara mund të mbahen edhe konferenca të tjera të jashtëzakonshme. Duke e ditur rëndësinë e këtij plani që ka për transparencën komunale, por, edhe për qytetarët tanë, shpresoj se ju do ta aprovoni atë. Në rast se keni pyetje lidhur me këtë plan, jam i gatshëm të ju përgjigjem.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës: A donë ta merr fjalën dikush ju lutëm?

znj.Mirlinda Sadiku: Kisha kërkuar pak sqarim, nëse ka mundësi sa i përket Web faqes së Komunës, shpeshherë ka informacione që nuk rifreskohen, d.m.th ki informacione që nga viti 2013, nuk janë rifreskua ato informacione për investimet kapitale që kanë ndodhur në vitin 2015, aty ceket vet investimet kapitale, nuk përmendet shuma e projektit dhe kur u kry. Nuk ka aktivitete të bollshme për Zyrën e Prokurimit, aktiviteti i fundit me sa e di unë është në shtator të vitit 2016 dhe mos të harrojmë se nja një muaj apo dy muaj nuk kemi pasur qasje në web faqe fare, si dhe më intereson ta di pse nuk ka pasur video seanca, d.m.th transmetim televizive, kur ne e dimë se kemi aprovuar një plan të prokurimit dhe aty u parashikë deri në fund të vitit dhe për vitin 2017: Pse nuk është hapur procedura e tenderimit?

z.Samet Idrizi: Sa i përket rregullsisë së faqes dhe dokumenteve që duhet të publikohen, vetëm se foli Mirlinda, unë vetëm desha me fol te neni 7, e drejta në qasje në dokumente publike. Pasi po flasim për një plan të veprimit mbi transparencën, ne kemi pas rastin kur këtu janë kërkuar dokumente dhe ka pasur shumë shpesh vonesa dhe në disa raste nuk janë afruar hiq, unë vetëm këtë kisha kërkuar, përndryshe ne do ta mbështesim këtë propozim vendim.

Kryesuesi: A ka dikush tjetër rreth kësaj pike? Pasi që nuk ka tjerë ja kisha dhanë fjalën z.Mustafës, të përgjigjet në pyetjet që u parashtruan.

z.Mustaf Mehmeti: Para se të kaloj në pyetjet, desha ta pyes Mirlindën, cilat dokumente nuk janë publikuar në Web faqe që nga viti 2013 e këndeje. Vlen të theksohet, se komuna jonë edhe vitin e kaluar ka aprovuar një plan të veprimit për transparencë, d.m.th ai plan ka ndikuar që për herë të parë të publikohen vendimet e kryetarit të Komunës dhe gjithashtu ka ndikuar që të publikohen dokumentet e prokurimit publik. Gjithashtu janë publikuar edhe shumë dokumente të prokurimit, ato që janë dërguar nga Zyra e Prokurimit, ato që nuk janë dërguar nuk janë të publikuar, gjithashtu vlen të theksohet, se për herë të parë në Komunën e Vitisë është publikuar edhe raporti i prokurimit publik për vitin 2016, d.m.th edhe kjo është fal planit të veprimit që kemi aprovuar ju dhe fal iniciativës që është bërë nga kryetari i Komunës. Mungesa e qasjes në Web faqe është për shkak të ministrisë, sepse gjitha Web faqet e komunave janë të standardizuara, d.m.th gjitha komunat kanë pas probleme. Sa i përket incizimeve të seancave, Zyra për Informim Publik ka përgatitur parallogarinë dhe paramasën dhe është në fazën e prokurimit publik tash që të shpallet tenderi. Sa i përket Sametit, qasja në dokumente publike, të gjitha kërkesat për dokumentet publike, që janë parashtruar në Komunën e Vitisë, kanë marrë përgjigje pozitive.

Kryesuesi z.Naim Pira: Nëse nuk ka dikush tjetër e kisha hedhë në votim këtë pikë të rendit të ditës. Konstatohet se me votat e të gjithë të pranishmëve u miratua edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të pestë të rendit të ditës kemi:

5. Propozim vendim për miratimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Zonën Ekonomike me statusin Park Industrial në fshatin Budrikë e Epërme.

Drejtorja e Urbanizmit i ka kryer të gjitha procedurat që i përkasin këtij plani, e ka zgjedh edhe kompaninë që e ka bërë këtë plan, unë po mendoj se në këtë seancë kishte me qenë mirë të jetë një votim ma tepër solemn, sepse po them janë shterr të gjitha mundësitë rreth kësaj pune. Si projekt është në fazën finale dhe ministria na ka thanë se shumë shpejtë do ta bëjë edhe alukimin e mjeteve, por, sidoqoftë unë do ja jap fjalën drejtorit në pika të shkurtra të na i elaboroj.

z.Ajet Sallahu: Me këtë propozim vendim, pasi që janë kryer të gjitha procedurat ligjore që dalin për hartimin e këtij plani, kërkoj miratimin e këtij plani rregullues të hollësishëm për zonën ekonomike me statusin park industrial në fshatin Budrikë e Epërme.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës: A donë ta merr fjalën dikush ju lutëm.

z. Samet Idrizi: Atëherë grupi i PDK-së, ju siç e dini opinioni jonë ka qenë kundër vendosjes jo kundër projektit, se projekti është shumë i mirë dhe besoj se do të ndikoj në zhvillimin e Komunës së Vitisë, për shkak se vendi aty ku do të vendoset kjo qendër industriale do të ju ekspozohet rrezikut të vërshimeve dhe për këtë ne do të abstenojmë.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Unë e dëgjova edhe kryesuesin, e dëgjova edhe drejtorin, e dëgjova edhe Sametin, në rast se në kontiunitet do të i përcjellim punët, unë me kënaqësinë do të kisha pa edhe grupin e PDK-së duke votuar, se gjërat nuk bëhen brenda mandatit, hartimi i planit urban është bërë në kohën e qeverisjes suaj, kur unë kam qenë në rolin e juaj, po them me sinqeritetin ma të madh po ju them, se jam kanë pro asaj pune me çka në planin zhvillimor komuna, ajo zonë është paraparë për zonë ekonomike edhe rrethanat kanë qenë të njëjta, megjithatë konsideroj se në rast se ne bëjmë luftë për zhvillim të mëtutjeshëm, unë mendoj me një investim për hapjen e “Moravës” do ti eliminojmë vërshimet dhe besoj se do të ishte shumë ma mirë se ne sot unanim ta votojmë këtë, se është për të mirë të qytetarëve dhe nuk do të ketë ndasi.

Kryesuesi z.Naim Pira: Atëherë nëse nuk ka diskutime, po e hedhi në votim këtë pikë të rendit të ditës. Prezent janë 20 këshilltar komunal: Kush është që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës? Me 11 vota pro, kalon kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të gjashtë të rendit të ditës kemi:

6. Raporti i Punësi Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, për periudhën Janar-Dhjetorë 2016

Ju e dini se Kuvendi Komunal e ka formuar këtë Këshill komunal për Siguri në Bashkësi, unë ja kisha dhanë fjalën nënkryetarit rreth kësaj pike të rendit të ditës.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Para jush e keni raportin e punës të KKSB-së, me çka ju një vit përpara e kishit edhe planin e punës që ta realizoj planin e vetë dhe në këtë raport e keni edhe mbajtjen e takimeve. Mos me ju marrë ma shumë kohë, pasi materialin e keni para jush, kisha lanë nëse ka ndokush ndonjë pyetje.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës: A donë ta merr fjalën dikush ju lutëm?

z.Baki Nebiu: Ky raport çka është shkruar e meriton çdo lavdatë, ajo çka po dua me thanë unë, është vjedhjet e fundit që kanë ndodhur në Komunën e Vitisë, e në laborimin e Policisë të premten kam qenë edhe këtu për dallim prej vitit të kaluar, ku vjedhjet kanë rënie, por, kjo nuk duhet të jetë

e kënaqshme, pasi që në këtë vit që e lamë pas, kanë ndodhur 230 raste të vjedhjeve të ndryshme në Komunën tonë, ku vetëm në Fshatin Kabash kanë ndodhur 14 raste, që i bie që çdo muaj të thehet një shtëpi e ma shumë. Unë po bëj apel si të policia edhe te gjykata, se më pëlqej përfundimi i elaburimit, ku kishte thanë: “synimi ynë arritja e besimit të qytetarëve me punën tonë”. Kërkoj prej policie edhe prej gjykate, që këto raste të qitën në drejtësi edhe besimi i qytetarëve do të jetë më shumë në policinë si dhe në gjykatën në Vitisë, pasi që nga frika qytetarët kanë ardhur në dy dyshime, po thonë se policia po i dinë po nuk po i merr, kurse një anë tjetër po thonë se policia po i merr, por, gjykata nuk po i dënon.

z.Bislim Bislimaj: Edhe unë e kisha dhanë një propozim në këtë aspekt, pasi që komuna jonë është komunë kufitare mes dy shteteve, kisha kërkuar të futet një kompetencë e veçantë për interesimin, që kufiri të jetë ma i sigurt, sidomos mos të bëhet tregti e palejueshme, në këtë raport ndoshta nuk është kompetencë, por, pak ka rreth kësaj.

Kryesuesi: Dikush tjetër, pasi që nuk ka, unë po e qes në votim për miratim: Kush është që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës? Konstatohet se me vota të shtatë pranishmeve u miratua edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të shtatë të rendit të ditës kemi:

7. Propozim vendim për shpalljen në diskutim publik për Propozim vendimin për rregullimin e komunikacionit në Qytetin e Vitisë dhe në territorin e saj

Me që e kemi këtu zyrtarin e kësaj drejtorie, e kisha lut që ta merr fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës.

z.Bushat Zuka: Ky propozim vendim ka rrjedh nga Drejtoria për Shërbime Publike, me iniciativë të drejtorit e ka propozu një grup punues, të cilin e ka miratuar kryetari i Komunës dhe grupi punues kemi filluar fazën e parë të punimit rreth këtij hartimi për rregullimin e komunikacionit në qytetin e Vitisë dhe territorin e saj, pasi materiali e keni merr me kohë, nuk po ju marr ma shumë kohë, po ju lë ju të debatoni, për pyetje apo për sugjerime jam në dispozicion të ju ndihmoj.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës: A ka dikush ta merr fjalën ju lutëm?

z.Bislim Bislimaj: Te faqja e fundit ki i kemi rekomandimet të këtij propozim vendimi, ku cekën disa pika shumë të rëndësishme, ku duhet me intervenua ma shpejtë, në kuadër të kësaj duhet me hy kalimi në fshatin Drobesh, nxënësit rrezikohen vazhdimisht, kam pa vende, si p.sh.: në Pratesh edhe Policia e Kosovës e ka bllokuar rrugën me kalua nxënësit, ndërsa në këtu punën ma të vogël që mund ta bëjmë në është mbikalim a diçka. Kisha propozua, se në këtë pikë të hy edhe kërkesa ime.

z.Bekim Azizi: Meqenëse është për diskutim publik dhe e kemi diskutuar edhe në KPF, megjithatë na i dhamë edhe vërejtjet, duhet të përmirësohen në emra të rrugës që ka kalua në Kuvend, rruga “Presheva” dhe rruga “Nikolla Tesla”. Nuk ekzistojnë tash me vendim të Kuvendit. Dhe tjetra, pjesa ma e madhe përshkruan një gjendje reale që është, mirëpo, sa i përket edhe çështjes së fshatrave, shumë pak është e përfshime këtu, vetëm thotë në koordinim me përgjegjësit e fshatit të caktohen ndaljet e autobusëve, por, besoj se pas diskutimit publik, ka mundësi me u plotësua ma shumë edhe do të dal një plan ma i mirë.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi nuk ka tjerë për të diskutuar, u po e qes në votim që të shkoj për diskutim publik, votojmë tash: Konstatohet se me vota unanime shkon për diskutim publik

Si pikë të fundit të rendit të ditës kemi:

8. Propozim vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër pronën e paluajtshme të Komunës kompanisë KEDS, për vendosjen e një tarfo elektrike në Qytetin e Vitisë

Ftoj drejtoreshën që ta merr fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës.

znj.Fatbardha Emini: Të nderuar anëtar të kuvendit, më lejoni që sot para jush të paraqesë propozim vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër pronën e paluajtshme të Komunës kompanisë KEDS, për vendosjen e një tarfo elektrike në Qytetin e Vitisë. Pasi materialin e keni marrë me kohë, për pyetje apo ndonjë sugjerim do të ju ndihmoj.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës: A donë ta merr fjalën dikush ju lutëm?

z.Bekim Azizi: Unë e kam shiku, po nuk kam mund me saktësu mirë vendimin, është mirë ma na ardhur me ortofoto, që ta dimë saktësisht vendin, se ku po e vendosim.

Kryesuesi z.Naim Pira: A ka dikush tjetër, nëse nuk ka, unë po e qes në votim për miratim edhe këtë pikë të rendit të ditës. Konstatoj se me vota unanime u miratua edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Unë ju falënderoj të gjithëve për kontributin që keni dhënë, mirupafshim në seancat e ardhshme.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 15:00 min.

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Naim Pira
